


## Çfarë duhet të dinë prindërit për platformën Twitch?

Epoka e transmetimeve online është tashmë një realitet i pandalshëm, dhe Twitch udhëheq këtë epokë me mbi 140 milionë përdorues aktivë çdo muaj. Twitch është ndër platformat më të njohura që përdoruesit e shfrytëzojnë për të parë lojtarë të tjerë që transmetojnë lojërat e tyre në kohë fikse/reale, duke u angazhuar me komunitetin e lojërave dhe jo vetëm kaq.

Në Twitch, përdoruesit mund të shohin të tjerët që luajnë lojëra në kohë reale, duke ofruar komente gjatë transmetimit. Përmes një sistemi të fuqishëm bisedash, transmetuesit mund të ndërveprojnë drejtpërdrejt me audiencën e tyre. Kjo e bën Twitch-in një platformë atraktive për lojtarë të të gjitha moshave. Shpesh, lojtarët hyjnë në Twitch për të parë lojërat e tyre të preferuara, për të biseduar me fansat dhe për të diskutuar ngjarjet e ndryshme. Nëse fëmijët tuaj janë të pasionuar pas lojërave, është e mundur që ata kanë treguar interes të theksuar për Twitch si platformë, dhe është e rëndësishme të siguroheni që ta përdorin platformën në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme.



Prindërimi

ÇFARË DUHET TË DINË PRINDËRIT PËR

# TWITCH

Twitch është ndër platformat më të njohura për të parë lojtarët që transmetojnë lojërat e tyre në kohë reale, me mbi 140 milion përdorues. Për ta kuptuar më mirë, mund të mendoni për Twitch si një version live të YouTube, ku përmbajtja është e drejtpërdrejtë (dhe nganjëherë e arkivuar), në vend që të jetë e regjistruar paraprakisht.

[www.prinderimi.com](http://www.prinderimi.com)

Twitch

## **Çfarë është Twitch?**

Sipas faqes zyrtare të platformës, *"Twitch është vendi ku miliona njerëz mbledhen çdo ditë për të biseduar, bashkëvepruar dhe për t'u argëtuar së bashku."*

Transmetuesit (*krijuesit që regjistrojnë dhe transmetojnë video të lojërave drejtpërdrejtë*) argëtojnë ndjekësit e tyre me përmbajtje të ndryshme, por kryesisht me lojëra. Për ta kuptuar më mirë, mund ta mendoni Twitch-in si një version live i YouTube-s, ku përmbajtja është e drejtpërdrejtë (*dhe nganjëherë e arkivuar*).

Twitch është zgjeruar përtej lojërave në formë video dhe tani mbulon tema të ndryshme, nga politika, udhëtimet e gatimi. Një ndër temat më të ndjekura jashtë lojërave është "Just Chatting" (*Vetëm bisedë*), ku transmetuesit flasin me audiencën përmes bisedave ose shërbimeve zanore si *Discord*.

## **A mund të komunikojnë fëmijët e mi me të tjerët përmes Twitch?**

Në thelb, Twitch është një platformë social. Transmetuesit mund të dërgojnë mesazhe të drejtpërdrejta (*DM*) ndjekësve, dhe ndjekësit mund të ndërveprojnë me njëri-tjetrin përmes funksionit të integruar të bisedës. Fëmijët tuaj mund të "ndjekin" transmetuesit e tyre të preferuar, duke marrë njoftime kur ata fillojnë një transmetim të drejtpërdrejtë. Shumë transmetues të njohur vendosin rregulla për bisedat në transmetimet e tyre dhe përdorin "*moderatorë bisedash*" për të disiplinuar përdoruesit që sillen në mënyrë të papërshtatshme.

Përdoruesit gjithashtu mund të fitojnë "*Pikë kanali*", të cilat përdoren për të kryer veprime të caktuara gjatë transmetimit, si theksimi i mesazhit të tyre ose kërkimi që transmetuesi të bëjë diçka specifike, si p.sh., të zgjedhë muzikën e sfondit. Pikët fitohen duke ndjekur transmetimet, duke biseduar dhe duke blerë abonime.

Edhe pse shumë transmetues ruajnë biseda të moderuara për të promovuar sigurinë, mesazhet private të padëshiruara, mund të ndodhin.


## A kushton para Twitch?

Twitch është falas, por ofron mundësi për të shpenzuar para. Ndërsa shumë transmetime brenda saj mbështeten nga reklamat. Transmetuesit shpesh marrin donacione nga komuniteti që i përcjellë ata, duke u mundësuar atyre ta kthejnë Twitch në një profesion me pagë të plotë.

Për përdoruesit që ndjekin transmetuesit e verifikuar nga Twitch (*partnerët dhe bashkëpunëtorët e platformës*), ekziston mundësia për të blerë abonime, nga të cilat transmetuesit marrin një përqindje të fitimeve. Disa transmetues përdorin edhe platforma si *Streamlabs*, *Patreon*, *Kofi* dhe *PayPal*, për të marrë donacione nga ndjekësit e tyre.

**Disa transmetues zhvillojnë biseda shumë të moderuara që promovojnë sigurinë, por mesazhet private të padëshiruara mund të ndodhin..**

Për ata që kanë Amazon Prime, janë të disponueshme edhe bonuset falas, si një abonim mujor falas në një transmetues Twitch dhe përfitime për lojëra të ndryshme, të cilat ndryshojnë çdo muaj. Këto përfitime mund të përfshijnë artikuj brenda lojërave apo ndonjëherë edhe lojëra falas. (*Twitch është në pronësi të Amazon.*) Kjo kërkon që llogaria e fëmijëve tuaj në Twitch të lidhet me një llogari Amazon Prime.



**Twitch nuk ofron kontrolle prindërore të integruara për shpenzimet**, prandaj është thelbësore që të bisedoni me fëmijët tuaj për kufijtë e shpenzimeve dhe të vendosni rregulla të qarta familjare sa para (*nëse realisht ka para të dedikuara për këtë gjë*) mund të shpenzohen. Nëse nuk dëshironi të bëni shpenzime, sigurohuni që të mos ruani asnjë informacion të kartës së kreditit në llogarinë e fëmijëve tuaj.

### **A ka përmbajtje të papërshtatshme në Twitch?**

Ashtu si shumë platforma të tjera sociale, Twitch mund të përmbajë përmbajtje të papërshtatshme që nuk lidhet drejtpërdrejt me videolojërat. Përmbajtjet ekskluzivisht për të rritur, siç janë ato me përmbajtje seksuale, janë të ndaluara sipas kushteve të shërbimit të Twitch. Megjithatë, duke qenë se një gamë e gjerë lojërash mund të transmetohet në Twitch, përfshirë lojërat me vlerësimin M për të rritur, fëmijët tuaj mund të ndeshen me përmbajtje që ju mund ta konsideroni të papërshtatshme. Duhet të keni parasysh se Twitch ndalon transmetimin e lojërave me vlerësim AO (*Vetëm për të rritur*).

Fatmirësisht, transmetuesit në Twitch mund të shënojnë përmbajtjet e tyre me "*Etiketat e klasifikimit të përmbajtjes*" (CCL), të cilat veprojnë si paralajmërim për shikuesit dhe prindërit në lidhje me përmbajtjen e transmetimit. *Këto etiketa ndihmojnë prindërit të menaxhojnë përmbajtjen që fëmijët e tyre shohin, përfshirë etiketa për:*

- **Lojë për të rritur (me përmbajtje krimi, terrori, vrasjesh, vjedhje gjakderdhje etj)**
- **Tema seksuale**
- **Përdorimi i drogës**
- **Intoksikimin**
- **Përdorimin e tepruar të duhanit**
- **Përshkrime të dhunshme dhe grafike**
- **Gjuhë fyese apo vulgaritet**
- **Bixhoz**

Në shumicën e rasteve, këto etiketa vendosen manualisht nga krijuesit, por Twitch i etiketon automatikisht transmetimet e lojërave me vlerësim M për të sinjalizuar prindërit dhe përdoruesit. *Për më shumë informacione rreth këtyre kërkesave, mund të vizitoni udhëzuesin CCL të Twitch.*

Përveç etiketimeve automatike për lojërat me vlerësim të maturuar, transmetuesve nuk u kërkohet të shfaqin vlerësimet ESRB për lojërat që luajnë. Kjo është një arsye më shumë për të diskutuar me fëmijët tuaj për transmetuesit që ndjekin, për lojërat që po luhen dhe për përmbajtjen që shfaqet. Ju i njihni fëmijët tuaj më mirë se kushdo, prandaj është gjithmonë e dobishme të hidhni një sy mbi transmetuesit e preferuar të fëmijëve tuaj për të parë se si sillen ata.

Gjithashtu, duhet të mbani parasysh se sjellja e transmetuesve mund të ndryshojë në varësi të lojërave që zgjedhin të transmetojnë. Edhe nëse një transmetues po luan një lojë me vlerësim E për të gjithë, kjo nuk do të thotë që sjellja e tij është gjithmonë e përshtatshme. Kjo nuk është domosdoshmërisht diçka e keqe, por është diçka për të cilën duhet të jeni të vetëdijshëm kur përcaktoni se çfarë është e përshtatshme për fëmijët tuaj.

### **Përmbajtja e papërshtatshme në Twitch që nuk lidhet me videolojërat**

Disa transmetues përdorin gjuhë të ashpër që mund të jetë e pakëndshme për disa prindër, ndërsa të tjerë transmetues mund të kenë një veshje sugjестive/të papërshtatshme. Disa prej tyre mund të diskutojnë tema përtej nivelit të pjekurisë apo të kuptimit të fëmijëve tuaj, si politika apo ngjarje aktuale në botë. Megjithëse asnjë prej këtyre nuk shkel automatikisht *udhëzimet e komunitetit të Twitch*, kjo është një vijë e hollë, dhe ju si prind duhet të vendosni për çfarë janë gati fëmijët tuaj të përballen. *Ky detaj përshkruhet më tej në udhëzuesin CCL të Twitch dhe në udhëzimet e komunitetit.*

### **Si të menaxhoni aktivitetin e fëmijëve tuaj në Twitch**

Twitch nuk ofron kontrollet prindërore të zakonshme, por ka disa masa të integruara që mund t'ju ndihmojnë të menaxhoni përmbajtjen që shohin fëmijët tuaj.

Në fillim, sigurohuni që llogaria e fëmijëve të ketë datën e saktë të lindjes kur regjistrohen. Kjo është e rëndësishme, veçanërisht për fëmijët nën 13 vjeç, të cilët mbrohen nga ligje të ndryshme

për mbledhjen e informacionit. Sipas kushteve të shërbimit të Twitch, vetëm fëmijët mbi 13 vjeç mund të krijojnë një llogari, dhe ata të moshës 13-18 vjeç vetëm nën mbikëqyrjen prindërore. Nëse një fëmijë nën 13 krijon një llogari, prindërit mund të kërkojnë fshirjen e saj duke kontaktuar Twitch përmes e-mailave dhe numrave të kontaktit.

Për fëmijët nën 18 vjeç, përmbajtje me etiketa si "*Tema seksuale*", "*Droga*" dhe "*Përdorimi i tepërt i duhanit*", do të filtrohet automatikisht. Ju mund të bllokoni ose kufizoni përmbajtjen duke përdorur funksionin "*Preferenca e shfaqjes së përmbajtjes*" në profilin e fëmijës tuaj.

### **Biseda në Twitch**

Twitch nuk ofron opsionin për të çaktivizuar bisedat, por mund të fshehni bisedën për ndërveprime personale. Nëse ky funksion nuk aktivizohet, të huajt mund t'ju dërgojnë "*Pëshpëritje*" (*mesazhe private*) fëmijëve tuaj. Këto mesazhe mund të bllokohen nga ata që fëmijët tuaj nuk ndjekin.

Twitch gjithashtu ka "*filtra bisedash*", që mund të përdoren për të bllokuar gjuhën e papërshtatshme. Megjithatë, këto nuk janë mbrojtura me fjalëkalim apo PIN, kështu që fëmijët tuaj mund t'i ndryshojnë cilësimet pa lejen tuaj. Prandaj, është e rëndësishme të bisedoni me ta dhe t'i përfshini këto masa si pjesë të rregullave të shtëpisë.

### **Përdorimi i Twitch pa krijuar një llogari**

Fëmijët tuaj mund të shikojnë transmetimet e Twitch edhe pa një llogari, por bisedat do të jenë të dukshme. Gjithashtu, përmbajtja me etiketa të ndaluara, si *temat seksuale*, do të filtrohen automatikisht. Sidoqoftë, identifikimi i fëmijëve ju ofron më shumë kontroll mbi përmbajtjen dhe ju lejon të aktivizoni më shumë funksione mbrojtëse.

### **Bisedat me fëmijët tuaj për Twitch**

Mjeti më i fuqishëm për prindërit është një dialog i vazhdueshëm dhe i hapur me fëmijët për përmbajtjen që konsumojnë në internet. Duke kuptuar cilët janë transmetuesit e preferuar të fëmijëve tuaj dhe pse, mund të keni një ide më të qartë për përmbajtjen që ata konsumojnë.

Në disa raste, mund të zbuloni se përmbajtja nuk është e përshtatshme dhe t'i shpjegoni atyre se çfarë lejohet dhe çfarë jo. Po ashtu, ju mund të shijoni bashkë transmetimet dhe ndoshta të provoni të luani lojën që transmetohet.

**Autore: Patricia E. Vance, presidente e Bordit ESRB**

**Përktheu dhe përshtati: Perparim Blakaj, Prinderimi.com**